



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio nr. 479/2017

lidhur me menaxhimin e papërshtatshëm të deponisë sanitare të mbeturinave në Velekincë të komunës së Gjilanit

**Për: Z. Lutfi Haziri, Kryetar
Komuna e Gjilanit**

**Z. Fatmir Matoshi, Ministër
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

**Z. Avdullah Haxhiu, Kryeshf
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A.**

Prishtinë, më 11 prill 2019

Qëllimi i raportit

Ky Raport me rekomandime është rrjedhojë e hetimeve të filluara nga Avokati i Popullit, sipas detyrës zyrtare. Hetimet kanë filluar bazuar në një shkrim të portalit “Rajonipress”, i datës 6 korrik 2017, me titull: “*Nga plagët e eskavatorit humb jetën një gjilanas*”.

Qëllimi i këtij raporti është të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe të Komunës së Gjilanit lidhur me mosarritjen e administrimit dhe mbajtjes nën kontroll të deponisë sanitare të mbeturinave në Velekincë të Gjilanit dhe mosndërmarrjen e masave nga organet përgjegjëse. Raporti synon të vë në pah ndikimin e keqmenaxhimit të deponisë në të drejtën për jetën dhe në të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të qytetarëve.

Baza ligjore

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime (...) me iniciativën e vet (ex officio), nëse (...) ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrument ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.” (neni 16, par. 4);
- “Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor” (neni 16, par. 8);
- “të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre” (neni 18, par. 1, nënpar. 1);
- “të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelini të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet për qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (neni 18, par. 1, nënpar. 2);
- “të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (neni 18, par. 1, nënpar. 4);
- “të njoftoj Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, par. 1, nënpar. 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nënpar. 6);
- “të rekomandoj nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës” (neni 18, par. 1, nënpar. 7);
- “të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e

të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 1, nënpar. 8);

- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi ligjore.

Përmbledhje e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmbledhen si në vijim:

1. Gjendja e deponisë sanitare të mbeturinave, e cila gjendet afër fshatit Velekincë të komunës së Gjilanit, është monitoruar vite me radhë nga IAP-ja, e deri në momentin e publikimit të Raportit. Që nga ajo kohë nuk është vërejtur ndonjë përmirësim i gjendjes së kësaj deponie.
2. Gjendja në këtë deponi ka qenë shqetësim edhe më i mëhershëm i Avokatit të Popullit, i shprehur edhe nëpërmjet komunikatave për media,¹ më 26 qershor 2012, nëpërmjet adresimit të çështjes tek organet kompetente komunale, në MMPH si dhe në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), duke u bërë thirrje që të ndërmarrin masa të menjëhershme për të administruar si duhet deponinë, pasi që mosarritja e mbajtjes nën kontroll e deponisë ka lënë mundësinë për depërtimin e lehtë të personave të paautorizuar, shpesh të fëmijëve dhe të miturve, brenda deponisë, të cilët, pa asnjë masë mbrojtëse, në momentin e shkarkimit të mbeturinave nga automjetet e mëdha/kamionët, depërtojnë afër impianteve të deponisë, pa asnjë masë sigurie, duke e rrezikuar jetën e tyre, qëndrojnë gjithnjë pranë ekskavatorit, i cili merret me palosjen e mbeturinave, duke përzgjedhur mbeturina/kanaqe, hekurishte dhe gjësende nga plastika, prej të cilave kanë përfitime.
3. Më 5 korrik 2017, punëtori i deponisë, i cili po e drejtonte ekskavatorin, derisa po lëvizte mbrapa, nga pakujdesia, e kishte goditur një person të moshës së re, i cili ishte duke mbledhur mbeturina, dhe i cili nuk kishte arritur t’u mbijetonte plagëve të marra.
4. Më 12 korrik 2017, përfaqësuesi i IAP-së kishte zhvilluar takim me përgjegjësin e deponisë, i cili kishte deklaruar se, më 30 qershor 2017, një punëtor i deponisë, derisa ishte duke punuar me ekskavator për shtrirjen e mbeturinave, në mënyrë aksidentale e ka goditur E. I., 23 vjeç. Sipas përgjegjësit të deponisë, zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës disa herë i kanë larguar personat e paautorizuar, në mesin e të cilëve ka edhe fëmijë të mitur, mirëpo, personat e paautorizuar vazhdojnë të hyjnë në deponi gjithnjë gjatë kohës së shkarkimit të mbeturinave nga kamionët, duke vënë në rrezik shëndetin dhe jetën e tyre.
5. Më 17 korrik 2017, përfaqësuesi i IAP-së e ka vizituar deponinë sanitare të mbeturinave dhe ishte njoftuar nga përgjegjësi i deponisë se është duke vazhduar gjendja e njëjtë,

¹ <https://oik-rks.org/2012/06/26>

sepse, edhe më tutje vazhdon hyrja e personave të paautorizuar në deponi nëpërmjet rrethojave të dëmtuara. Më tej ai ka theksuar se, edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme që u drejtohen atyre për t'u larguar, këto kërkesa injorohen.

6. Gjendja e pandryshuar vërehej edhe më 22 qershor 2018, kur përfaqësuesi i Avokatit të Popullit e vizitoi deponinë sanitare të mbeturinave. Brenda hapësirës së deponisë vërehej se po mblidhnin mbeturina mbi 30 persona, e në mesin e tyre afro 12 fëmijë, gjatë kohës së shkarkimit të kamionëve.
7. Më 10 shtator 2018, përfaqësuesi i IAP-së u njoftua nga drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Gjilan se, lidhur me çështjen e punës së fëmijëve në deponinë sanitare, janë njoftuar institucionet komunale, duke shtuar se ai ka biseduar me anëtarët e familjeve fëmijët e të cilëve punojnë në deponi, ndërsa të gjitha familjet, të cilat i plotësojnë kriteret, e marrin ndihmën sociale.
8. Më 17 tetor dhe 7 dhjetor 2018, përfaqësuesi i IAP-së e vizitoi deponinë e mbeturinave dhe u njoftua nga përgjegjësi i saj se situata nuk ka ndryshuar sa i përket hyrjes në deponi të personave të paautorizuar, të cilët për çdo ditë hyjnë aty. Sipas përgjegjësit të deponisë, KMDK-ja e ka planin e veprimit, ku është paraparë pengimi i qasjes në deponi i personave të paautorizuar, të cilët vazhdojnë të hyjnë në deponi edhe pse kërkohet prej tyre që të mos hyjnë.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

9. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 3, përcakton: "*Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake.*"
10. Një ndër instrumentet ndërkombëtare që garanton të drejtat dhe liritë e njeriut, e paraparë me nenin 22 të Kushtetutës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.
11. Në mënyrë që të drejtat dhe liritë themelore, të garantuar me Kushtetutën e vendit, të interpretohen në pajtim me vlerat e shoqërisë së hapur dhe demokratike dhe në pajtim me praktikën e organeve ndërkombëtare, të cilat i mbikëqyrin ato, Kushtetua, në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], ka precizuar: "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*"
12. Edhe pse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj nuk kanë parashikuar ndonjë të drejtë për mjedis të shëndetshëm, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) vazhdimisht ka zhvilluar jurisprudencën e saj në çështjet mjedisore, për shkak të faktit se ushtrimi i të drejtave të caktuara nga Konventa mund të preket nga vetë ekzistenca e dëmeve dhe e ndotjes së mjedisit, si dhe i ekspozimit të individëve në mjedise që përbëjnë rrezik.
13. Lidhur me ndikimin e mjedisit në të drejtat e njeriut, GjEDNj-ja ka theksuar se autoritetet publike janë të detyruara të ndërmarrin masa për të siguruar që të drejtat e njeriut të mos preken seriozisht nga faktorët e dëmshëm mjedisorë.

14. Sipas Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i mbeturinave² është përcaktuar si kompetencë ekskluzive e komunave.
15. Mirëpo Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, i cili ka për qëllim parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, në nenin 13, paragrafi 1, përcakton se autoritetet kompetente për administrimin e mbeturinave janë Ministria dhe komunat.
16. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, KMDK-ja është kompani e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave komunale në Republikën e Kosovës, e regjistruar si shoqëri aksionare në përputhje me Ligjin nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.
17. Ligji për Mbeturina ka paraparë që operatorët për menaxhimin e mbeturinave janë të detyruar të nxjerrin Planin e veprimit për menaxhimin e mbeturinave. Sipas nenit 12, paragrafi 2.6, saktësohet se plani i veprimit parasheh menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kushteve të punës në objekte dhe pajisje, kontrollimin dhe njoftimin për pengimin e qasjes së kafshëve dhe shpezëve dhe kontrollin e bartjes së mbeturinave nga personat e paautorizuar.
18. Ndërsa sipas nenit 12, paragrafi 3.1, Plani i menaxhimit të deponive duhet të përmbajë përshkrimin e karakteristikave të lokacionit dhe identifikimin e burimeve të rrezikut gjatë menaxhimit të mbeturinave (...); si dhe në paragrafin 3 parasheh infrastrukturën e deponisë për mbeturina: rryma, uji, kanalizimi, rruga dhe rrethoja.
19. Ligji ka lënë në kompetencë komunale mbikëqyrjen dhe kontrollin e mbeturinave, brenda territorit komunal. Paragrafi 3 i nenit 15 përcakton: *“Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimit të mbeturinave në territorin, përmes inspektorit komunal për mjedis.”*
20. Sipas nenit 62, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina, mbikëqyrjen inspektive për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij, kushtet dhe mënyrën e punës së personave të mbikëqyrur, si dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut nga mbeturinat, të përcaktuara me këtë ligj, e bën Inspektorati Mjedisor i Ministrisë dhe inspektorati komunal në kuadër të përgjegjësive sipas këtij ligji.
21. Bazuar në nenin 62, paragrafi 5, Inspektori, me vendim, mund të urdhërojë apo të ndalojë personin që menaxhon me deponitë e mbeturinave, me qëllim të mënjanimin të parregullsisive, nëse konstaton se nuk është duke i zbatuar detyrimet dhe kushtet e përcaktuara me licencë për deponi, gjegjësisht:
 - 5.5. nuk kontrollon deponinë gjatë kohës aktive të shfrytëzimit;
 - 5.6. nuk bën monitorimin dhe mirëmbajtjen e deponisë pas mbylljes së saj;
 - 5.7. nuk zbaton masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis të përcaktuara në licencën për menaxhimin e mbeturinave.
22. I njëjti nen ka saktësuar ndalimin e përkohshëm nëse konstaton:

² Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17: Kompetencat vetanake, par. e, f.

- 6.1. ushtron veprimtarinë në objekte apo hapësira afariste të cilat nuk i plotësojnë kushtet sipas dispozitave ligjore;
- 6.3. nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në licencë për menaxhimin e mbeturinave;
- 6.4. nuk vepron në pajtim me licencën ose dokumentacionin e lëshuar nga Ministria;
- 6.5 nuk vepron në pajtim me zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- 6.6 në afatin e caktuar sipas vendimit nuk ndërmerr masat e kërkuara.
23. Neni 63 [**Autorizimet e inspektorit**] ka precizuar saktësisht se, gjatë kryerjes së punëve të mbikëqyrjes inspektive, inspektori ka të drejtë dhe detyrim të verifikojë dhe kontrollojë: *“1.3 plotësimin e kushteve për ndërtimin dhe funksionimin e objekteve, pajisjeve dhe instalimeve, për trajtimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave.”*
24. Po ashtu, neni 63 ka autorizuar inspektoratet që, gjatë zbatimit të mbikëqyrjes inspektive, nëse konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra prej këtij ligji, të urdhërojnë zbatimin e masave me të cilat sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njeriut në objektet për menaxhimin e mbeturinave.
25. Neni 66, paragrafi 1, i po këtij Ligji përcakton: *“Inspektori mjedisor komunal mbikëqyrë dhe inspekon menaxhimin e mbeturinave në objektet pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës përkatëse, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuar sipas dispozitave të këtij ligji.”*
26. Sipas nenit 65.4, nëse inspektori gjatë zbatimit të mbikëqyrjes inspektive konstaton shkeljen e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra prej këtij ligji, është i autorizuar të: *“4.5. urdhëroj zbatimin e masave me të cilat sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, në objektet për menaxhimin e mbeturinave.”*

Analiza ligjore

27. Kushtetuta, akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve. Prandaj kjo është domosdoshmëri e kohës dhe duhet të respektohet nga autoritetet publike.
28. Kushtetuta nuk lë hapësirë që institucionet të neglizhojnë krijimin e mjedisit të sigurt dhe të shëndetshëm për qytetarët, e aq më pak moszbatimin e ligjshmërisë për mbrojtjen e mjedisit, duke precizuar nenin 52, paragrafi 1: *“Natyra dhe bisodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.”*
29. Avokati i Popullit, pas analizës së çështjes, hetimit dhe monitorimit të gjatë të administrimit të deponisë sanitare të mbeturinave në Gjilan, ka vërejtur se deponia nuk menaxhohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Përveç keqmenaxhimit të mbeturinave në impiant, problemin me trajtimin e mbeturinave etj., zjarret e herëpashershme, kundërmimet, mosmenaxhimi i duhur i kullimit dhe shkarkimi i ujërave në tokë pjellore, me ndikim të vazhdueshëm në të drejtat e njeriut, mosarritja e vendosjes nën kontroll e deponisë nga operatori, me një rrethojë të qëndrueshme, e cila do të pengonte hyrjen e paautorizuar, tregon dështimin e shtetit për menaxhimin e problemit.

30. Praktika e GjEDNj-së, bazuar në nenin 2 të Konventës [E drejta për Jetën], jep mendimin që shteti duhet të vendosë detyrime pozitive për t'i marrë masat e nevojshme për të mbrojtur jetën e qytetarëve brenda juridiksionit të tij³. Neni 2 i obligon autoritetet publike të ndërmarrin hapa për të garantuar të drejtat e parapara në Konventë, edhe atëherë kur të drejtat kërcënohen nga persona të tjerë (privatë) ose aktivitetet që nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me shtetin. Sipas Gjykatës, obligimi pozitiv i shteteve mund të aplikohet në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme ose të vendeve të grumbullimit të mbetjeve, qoftë të transportuara nga vetë autoritetet publike ose nga kompani private. Në përgjithësi, shkalla e detyrimeve të autoriteteve publike varet nga faktorët se sa është ndikimi i aktiviteteve të rrezikshme dhe parashikimi i rrezikut për jetën⁴.
31. Avokati i Popullit vlerëson se Inspektorati komunal, po ashtu edhe ai i MMPH-së, përkundër bazës së mjaftueshme ligjore, problemeve serioze lidhur me mbajtjen nën kontroll të deponisë, të cilat kanë rezultuar me humbje jete, nuk kanë ndërmarrë masa në përputhje me legjislationin në fuqi, për të urdhëruar apo ndaluar operatorin që menaxhon me deponinë e mbeturinave, për të mënjanuar parregullsitë në rrethojën e deponisë, përmes së cilës kanë hyrë personat e paautorizuar, duke rrezikuar jetën dhe shëndetin e tyre.
32. Avokati i Popullit gjen se gjykata në rastet *Oneryldiz v. Turkey*, par. 93, dhe *Budayaeva and Others v. Rusia*, par. 140, ka theksuar se rastet që në veçanti kanë të bëjnë me veprimtari të rrezikshme kur autoritetet publike janë plotësisht të vetëdijshme për pasojat e mundshme dhe nuk i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre për evitimin e rrezikut, duke mos arritur të marrin masa që janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'i shmangur rreziqet që mund të shkaktojnë edhe humbje të jetës, dhe shkelje të nenit 2 të KEDNj-së, kërkohet që përgjegjësit për rrezikim të jetës të ngarkohen me vepra penale apo të ndiqen penalisht.
33. Duke marrë parasysh që nga mosmarrja e veprimeve nga organet kompetente për të penguar hyrjen e personave të paautorizuar në deponi, ka rezultuar me vdekjen e një personi, Avokati i Popullit ju sjell në vëmendje vendimin e GjEDNj-së në rastin *Oneryldiz v. Turkey* lidhur me dështimin e autoriteteve për ndërmarrjen e masave efektive dhe parandaluese, ku kishte gjetur shkelje të nenit 2, për arsye të mungesës së ndërmarrjes së hapave të duhur nga shteti për të parandaluar vdekjen e nëntë banorëve, të cilët jetonin pranë një deponie mbeturinash. Gjykata theksoi se shteti është përgjegjës, pasi që nuk kishte ndërmarrë masat e nevojshme praktike për të shmangur rreziqet për jetën e njerëzve.
34. Avokati i Popullit, duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e ofruara, faktet e mbledhura, si dhe ligjet relevante, thekson se, në rastin konkret, ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, pasi që autoritetet përgjegjëse, të cilat, sipas legjislationit në fuqi, kanë kompetencë dhe obligim ndërmarrjen e detyrimeve pozitive lidhur me rastin, kanë dështuar në plotësimin e detyrave dhe përgjegjësiive të tyre në raport me qytetarin.
35. Depërtimi i pakontrolluar i personave të paautorizuar në deponi për vite me radhë, mosarritja e ushtrimit të kontrollit nga personat kompetentë brenda deponisë,

³ *L.C.B. v. the United Kingdom, judgment of 9 June 1998, paragraph 36*

⁴ *Oneryldiz v. Turkey [GC] paragraph 73; L.C.B. v. the United Kingdom, paragraph 37-41*

mosndërmarrja e veprimeve nga inspektorati i nivelit qendror dhe komunal, janë tregues i mjaftueshëm i dështimit të zbatimit të dispozitave ligjore të dala nga Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina.

36. GjEDNj-ja, në rastin *L.C.B. v. the United Kingdom*, ka dhënë mendimin se shtetet kanë obligim pozitiv që t'i marrin masat e duhura për të mbrojtur jetën e qytetarëve brenda juridiksionit të tyre.

Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se: “Vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për personat juridikë dhe fizikë”; me qëllim të respektimit të nenit 25 të Kushtetutës [E drejta për Jetën] dhe të nenit 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], dhe në mënyrë që autoritetet, me hapa të përshpejtuar, të ndërmarrin masa efektive për menaxhimin e deponisë së mbeturinave, në bazë të analizës së rastit dhe konstatimeve të arritura, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 18, paragrafët 1.5 dhe 1.7, të Ligjit për Avokatin e Popullit, i

REKOMANDON

- **Komunës së Gjilanit që, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe nëpërmjet inspektoratit komunal për mjedis, të ushtrojë mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve për mbeturinat;**
- **Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Gjilanit që, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, në bashkëpunim edhe me autoritetet tjera, të ndërmarrin masa të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të deponisë sanitare të mbeturinave në fshatin Veleknicë dhe mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit të njeriut nga mbeturinat;**
- **Kompanisë për Menaxhimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK) Sh.A. që, në pajtim me kompetencat, t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për menaxhimin e deponisë sanitare të mbeturinave në fshatin Velekincë dhe ta zbatojë Planin e veprimit për largimin e personave të paautorizuar nga deponia.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarrja lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit